



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 25 maj 2010, në mbledhjen e dytë të Komitetit për komunitete.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.00.

Mbledhjen e hapi z. Shaban Ahmeti, kryesues i Komitetit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht z. Burhan Blekçori, z. Nebih Behluli, z. Arbresha Hetemaj, z. Shaban Ahmeti, z. Jahë Lahu dhe z. Selver Rama, ndërkaq mungoi z. Radisav Peroviq.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe z. Mefail Mustafa OSBE – Zyra regjionale për komunitete, z. Driat Cerabregu, OSBE dhe z. Martina Huskova, LMT – KFOR

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri

2. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 27 prill 2010

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Shqyrtimi i Planit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2010

z. Nebih Behluli, njoftoi se Komisioni i ngritur në mbledhjen e kaluar ka mbajtur një takim dhe e ka hartuar propozimin e planit të punës të këtij Komiteti, propozim i cili është një bazë e mirë për aktivitetet gjatë vitit 2010, dhe shtoi se gjithsesi do të jenë të mirëseardhura edhe sugjerimet dhe plotësimet e anëtarëve të tjerë të këtij Komiteti.

z. Arbresha Hetemaj, u pajtua me parafolësin dhe shtroi nevojën e angazhimit të përbashkët për realizimin e këtij plani të punës.

z. Burhan Blakçori, shprehu mendimin se propozimi i këtij plani të punës përfshin pikat kryesore për përkujdesje ndaj komuniteteve dhe se mbetet vetëm të caktohen datat kur parashihet të vizitohen tri komunat e parapara për vizita dhe se me këtë plotësim ky propozim mund të miratohet.

z. Jahë Lahu, në tërësi e përkrahu propozimin e planit të punës dhe u interesua të dijë se a ka mjete buxhetore për implementimin e të njëjtit.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, parafolësin e njoftoi se me ndihmën e OSBE-së përbërja e kaluar e këtij Komiteti i ka vizituar disa komuna të Kosovës dhe shprehu bindjen se kjo ndihmë nuk do të mungojë dhe në të ardhmen, ashtu siç nuk do të mungojë edhe ndihma e Komunës si në rastin kur Podujeva ka qenë nikoqire e përfaqësuesve të Komiteteve për Komunitete të disa komunave të Kosovës.

z. Mefail Mustafa, Zyra regjionale për komunitete e përkrahu punën dhe angazhimin në hartimin e planit të punës së këtij Komiteti dhe shtoi se Komiteti për Komunitete në Komunën e Prishtinës e ka miratuar planin e punës dhe kanë filluar aktivitetet për implementimin e të njëjtit.

OSBE e ka përkrahur punën e Komiteteve për Komunitete në Prishtinë dhe Fushë Kosovë, komuna në të cilat edhe janë organizuar trajnime përkatëse iniciativë e cila do të shtrihet edhe në komuna të tjera të Kosovës.

Në vazhdim theksoi se do të shikohen mundësitë që të organizohen vizita në kuadër të komunave të regjionit të Prishtinës, ndërkaq për vizita jashtë këtij regjioni është e nevojshme të kontaktohet me ekipet e OSBE-së të regjioneve përkatëse.

z. Nebih Behluli, theksoi se në propozimin e planit të punës janë paraparë të vizitohen tri komuna përkatëse, mirëpo gjithashtu është lënë e hapur edhe mundësia për vizita në Komuna të tjera dhe se sigurisht do të jenë të mirëseardhura vizitat në komunat në kuadër të regjionit të Prishtinës.

Në vazhdim, pas propozimeve të bëra, njëzëri u vendos që në planin e punës të përfshihen edhe vizitat:

- Lagjja e sekiraqëve në fshatin Metergofc
 - o Afati i realizimit: Qershor 2010
- Fshati Orllan
 - o Afati i realizimit: Shtator 2010
- Fshati Batllavë
 - o Afati i realizimit: Tetor 2010
- Podujevë rr. "Ali Ajeti"
 - o Afati i realizimit: Nëntor 2010
- Podujevë lagja në rr. "Xhafer Meta"
 - o Afati i realizimit: Dhjetor 2010

Gjithashtu u përcaktua që Komuna e Pejës të vizitohet në muajin qershor 2010, Komuna e Prizrenit në shtator 2010, ndërkaq Komuna e Ferizajt në tetor 2010.

Datat e përafërta për mbajtjen e mbledhjeve të Komitetit për Komunitete, u caktuan si në vijim:

15 qershor 2010

2 korrik 2010

6 shtator 2010

15 tetor 2010

10 nëntor 2010, dhe

23 dhjetor 2010

Propozimi i planit të punës me plotësimet e cekura u miratua njëzëri.

4. Të ndryshme

z. Martina Huskova, LMT – KFOR, njoftoi se nga këndvështrimi i KFOR-it situata e sigurisë në Komunë është e qetë.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, theksoi se për mbarëvajtjen e punëve dhe aktiviteteve të këtij Komiteti është e nevojshme siguri i një zyreje dhe punësimi i stafit prej dy apo tre personave dhe shtoi se një kërkesë e këtillë është shtruar edhe më parë por deri më tash nuk është zgjidhur kjo çështje.

z. Mefail Mustafa, nënvizoi se me Ligjin për vetëqeverisje lokale, Komiteti për Komunitete është njëri prej dy Komiteteve të obliguara, pra mbi këtë bazë kërkesa e parafolësit është legjitime dhe e njëjta do duhej t'i dërgohet për shqyrtim Kuvendit të Komunës dhe shtoi për të qenë më i qartë dua të them edhe këtë se kjo nuk ka të bëjë me Zyrën për Komunitete por për një zyrë në të cilën Komiteti për Komunitete do të ushtronte veprimtarinë dhe aktivitetet në kuadër të kompetencave të tij.

z. Nebih Behluli, shprehu mendimin se çështja e shtruar nga kryesuesi z. Shaban Ahmeti është e bazuar dhe se për zgjidhjen e të njëjtës e ka mbështetjen e tij personale por edhe të subjektit politik PDK.

Njëzëri u vendos që lidhur me sigurimin e zyrës për nevoja të Komitetit për Komunitete fillimisht të bisedohet me Kryetarin e Komunës dhe nëse nuk gjendet zgjidhja atëherë t'i shtrohet kërkesë Kuvendit të Komunës.

Mbledhja përfundoi në orën 11.50.

Procesverbalin e mbajti

Faik Gashi

Nr. 01/166-06

Podujevë,

25 maj 2010

**Kryesuesi i Komitetit
Shaban Ahmeti**